

# Gratë u ndihmojnë grave

Schwarzwald-Baar e.V.

## Çka mund të bëj unë?

### Çka të bëhet te dhuna?

- Mbroni veten dhe fëmijët!
- Gjatë një kërcënimi akut thirrni policinë – telefoni: 110
- Policia mund t'ju ndërmjetësojë në një shtëpi mbrojtëse për gra dhe për fëmijë.
- Policia ka mundësi që burrin e dhunshëm ta largojë nga banesa deri në 14 ditë.

Shfrytëzoni kohën: Na kontaktoni neve ose një avokate!  
Informohuni atje për te drejtat tuaja!

### Çka të bëhet te lëndimet?

- Nëse ju ose fëmijët jeni lënduar fizikisht, bëni kontrollën mjekësore dhe merrni një vërtetim mjekësor.
- Në rast nevojë dokumentoni lëndimet vetë dhe ia tregoni ato një personi të besueshëm!

### Çka të bëhet, nëse kanoset dhuna?

- Thirrni këshillimoren tonë. Ne ju përgjigjem në të gjitha pyetjet tuaja – telefoni: 07721-54400

### Çka të bëhet, nëse duhet të shkohet në shtëpi për gra?

Nëse vendosni për një qëndrim në shtëpi mbrojtëse për gra dhe për fëmijë, nëse është e mundshme sillni me vete këto gjëra:

- Letërnjoftimin dhe pasaportën, edhe të fëmijëve
- Kartelën e sigurimit shëndetësor, edhe të fëmijëve
- Të holla, kartelat e bankës, librezat e kursimeve
- Medikamentet, eventualisht librezat e vaksinimit
- Sendet e shkollës, eventualisht dëftesat
- Rrobat
- Kafshën lodër të preferuar për përkdhelje dhe lodrën e preferuar të fëmijëve

### Çka tjetër?

Numri i telefonit në çdo kohë, në shumë gjuhë dhe gratis në tërë Federatën!

**TELEFONI NDIHMËS**  
DHUNA KUNDËR GRAVE  
08000116016

Informata tjera gjeni në: [www.hilfetelefon.de](http://www.hilfetelefon.de)

## Këshillim dhe ndihmë për gra dhe vajza